

VENDIM
Nr. 47, datë 27.11.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN, NR. 34, DATË 15.7.2015, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE, SI DHE PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR
PROJEKTET NË VAZHDIM PËR PROGRAMIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE,
PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 34, datë 15.7.2015, “Për shpërndarjen e fondit për programin ujësjellës-kanalizime, shpalljen e thirrjes për aplikime për programin e ujësjellës-kanalizimeve, si dhe një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve”, bëhen ndryshime, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpërndarjen e fondeve për financimin e vlerës së pafinancuar nga vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për projekte në vazhdim, me cikël financimi 2012–2013, për programin e ujësjellës-kanalizimeve, specifikuar sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.

Tabela 1. Ndryshim në tabelën 1, që i bashkëlidhej vendimit nr.34, datë 15.7.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr.3 i ndryshon autoriteti kontraktues, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Financimi për vitin 2015 (në lekë)	Financimi për vitin 2016 (në lekë)
		QARKU VLORE			
3	Bashkia Finiq	Ndërtimi i ujësjellësit Navaricë - Memoraq – Dermish, Komuna Dhivër	62,262,248	12,452,450	49,809,798

Shënim:

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues). Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës).
2. "Vlera e financimit" për vitin 2015 tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objektit.
3. "Vlera e financimit", për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së projektit dhe vlerës së financimit për vitin 2015.

Tabela 2. Projektet në vazhdim, program Ujësjetllës-Kanalizime, me cikël financimi 2012-2013

Nr.	Ish-autoriteti kontraktues	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e kontrates (në lekë)	Vlera e disbursuar deri në fund të vitit 2014	Vlera e mbetur për financim për vitin 2015
QARKU BERAT						
1	Komuna Velabisht	Bashkia Berat	Ndërtim KUZ i fshatit Vetërrik	23,311,233	10,864,613	12,446,620
QARKU DIBËR						
2	Komuna Gurre	Bashkia Klos	Ndërtimi i rrjetit K.U.Z te fshatit Shulbater	13,901,200	6,379,560	7,521,640
QARKU ELBASAN						
3	Bashkia Cërrik	Bashkia Cërrik	Ndërtim KUZ ne lagjet Nr.1, 2, 3 Cërrik	26,885,210	9,578,188	17,307,022
QARKU FIER						
4	Komuna Cakran	Bashkia Fier	"Rikonstruksion i linjave te dergimit te ujesjetlesit rajonal Cakran "	10,522,741	3,509,117	7,013,624
5	Komuna Strum	Bashkia Roskovec	KUZ fshati Velmish	64,686,139	64,476,131	210,008
QARKU GJIROKASTËR						
6	Komuna Zagori	Bashkia Libohovë	KUZ ne Nivan	5,125,250	2,053,584	3,071,666
7	Komuna Luftinje	Bashkia Memaliaj	KUZ fshati Izvor	18,008,580	3,499,860	14,508,720
QARKU TIRANË						
8	Komuna Zall-Bastar	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion i ujesjetlesit Qender Zall Bastar	21,511,420	14,334,039	7,177,381
9	Bashkia Vore	Bashkia Vorë	Ujesjetlesi Rajonal Vore - Gjokaj - Picar - Dedej	80,000,000	43,463,435	36,536,565
QARKU VLORË						
10	Komuna Shushice	Bashkia Vlorë	KUZ i fshatrave Llakatund dhe Shushice	38,799,788	37,949,680	850,108
TOTALI				302,751,561	196,108,207	106,643,354

Shënim:

1. "Ish autoriteti kontraktues", përfaqëson autoritetin kontraktues "komunat", të cilësuar "njësi që shkrihen" nga reforma territoriale – administrative e vitit 2015.
2. "Autoriteti kontraktues", përfaqëson autoritetin e ri kontraktues "bashkia", të cilit i kanë kaluar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kontratave, të "njësive që shkrihen".
3. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoritetit kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).
4. "Vlera e disbursuar deri në fund të vitit 2014" tregon vlerën e disbursimit për vitin 2014, sipas Ministrisë së Financave, për vitin 2014.
5. "Vlera e mbetur për financimit për vitin 2015", tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së disbursuar për vitin 2014.